



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 3662/2022  
Data: 23.05.2022

### PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e katërt -IV- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 28.04.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: z.Mehmet Ballazhi (Kryetar i Komunës), Majlinda Kaloshi (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), Kimete Kuka -Hasallari (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Nekmedin Daci (Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Lindita Ballazhi (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), Hisni Luri (Drejtësor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Abduraman Bushi (Drejtësor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Sara Berisha (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Bashkim Sopa (Zyrtarë për Informim), Përfaqësuesit e OSB-së. Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

### RENDI I PUNËS

1. Betimi i anëtares së re të kuvendit të komunës znj.Hatmije Kalisi.
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
3. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2022.
4. Kërkesë për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2021 në vitin 2022.
5. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare për javën kulturore 2022 në Komunën e Hanit të Elezit.
6. Plotësim ndryshimi i rregullores për kushtet , kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.
7. Informatë për ndarjen e bursave.
8. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2022 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
9. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- pika e rendit të punës hapi diskutimin.

**Zaim Bela** thekson:- pika e katër e rendit të punës që është shënuar kërkesë, mirëpo do të ishte më mirë me bërë propozim vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2021 në vitin 2022.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

## **1. Betimi i anëtares së re të kuvendit të komunës znj.Hatmije Kalisi.**

**Kryesuesi** thekson:- ftoj znj.Hatmije Kalisi që ta lexoj tekstin e betimit.

**Hatmije Kalisi** thekson:- betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvendit të komunës së Hanit të Elezit , në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### **U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**

## **3. Raporti finansiar për periudhën Janar – Mars 2022.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Resul Suma** thekson:- shpenzimet për paga dhe shtesa krahasuar me vitin e kaluar ka një rënie prej 10 % , kërkoi sqarim pse ka ndodhur kjo rënie.

**Lindita Ballazhi** thekson:- shtesa te zyrtarët komunal nuk ka pasur për veç zyrtarëve të cilët kanë kryer punë jashtë orarit të punës e jo brenda orarit.

**Veton Ballazhi** thekson:- pse në këtë vit keni shpenzuar më shumë se në vitin paraprakë për udhëtime zyrtare brenda vendit, transportin e nxënësve . Pse nuk kemi të hyra indirekte në tre mujorin e parë

**Lindita Ballazhi** thekson:- shpenzimet për transportin e nxënësve në krahasim me tre mujorin e parë të viti të kaluar kemi rritje për disa arsyesh sepse kemi pasur shpenzime të trashëguara nga ish qeverisja dhe po ashtu ka ndikuar edhe rritja e çmimeve të karburanteve . Sa i përket të hyrave indirekte raportin na i përcjellë Ministria dhe na është përcjell në muajin prill ndërsa ky është raport tre mujorë , e shuma prej të hyrave indirekte është në shumë prej 3720 € , ndërsa nëse krahasohet me vitin e kaluar ka qenë 2550 € , që do të thotë kemi një rritje të tē hyrave indirekte.

**Sherif Berisha** thekson:- kërkoi sqarim për çështje të kodeve te buxheti i komunës te kategoritë ekonomike dhe atë kodi 16335 që do tē thotë se është i njëjtë kod në dy apo tri vende, kodi 92175 është në dy vende. Kërkoi sqarim pse është i njëjtë kodë dhe pse është largësia te buxheti i komunës sipas kategorive ekonomike.

**Lindita Ballazhi** thekson:- te tē gjitha raportet se si është e renditur renditja e kategorive janë tē gatshme prej Ministrisë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kodet buxhetore shpërndahen prej nivelit qendrorë, pavarësisht se cila drejtori kodet buxhetore nuk ndryshojnë sepse janë tē përcaktuara sipas nivelit qendrorë dhe ne si komunë nuk mund ti ikim formatit.

**Nora Xhoni** thekson:- tabela 4.5 te shpenzimet kapitale shtimi i kapaciteteve tē ujtit dhe rregullimi i ujësjellësit a është dashur tē shënohet në mënyrë specifikë vendi se në cilin vend janë duke u bërë punimet për shkak se në tabelarët tjera është shënuar vendi i realizimit tē projektit.

**Lindita Ballazhi** thekson:- kjo pyetje ka të bëjë më shumë me drejtorinë e urbanizmit për shkak se drejtoria e financave e ka kryer pjesën financiare.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- sa i përket shtimit të kapaciteteve të ujit dhe rregullimit të ujësjellësit janë planifikime të më hershme, ne kemi potencuar se do t'i vazhdojmë punimet të cilat kanë mbetur në gjysmë dhe ju e dini që për momentin janë duke u kryer punimet te fabrika e ujit e gjithçka që ka të bëjë me shpenzimet bëhet fjalë për të fabrika e ujit në fshatin Dimcë.

**Zaim Bela** thekson:- sa i përket raportit të shpenzimeve në krahasim me performacën e raportit të viti kaluar ka një rënie në shumë prej 98421.00 € në krahasim me tremujorin e vitit të kaluar. Në dy kategori ekonomike shpenzimet janë zero zero pra te subvencionet dhe te investimet kapitale kërkoj sqarim. Në performancën e të hyrave shihet se është mirë realizimi. Faqe pese te buxheti komunale 2022 ku është shënuar ligji i buxhetit është gabim dhe duhet të përmirësohet. Përqindja e shpenzimeve për periudhën janar mars diku shënon 15 % por mendoj se duhet të jetë 14.99 %, ndërsa faqe gjashtë e keni 14.95 %. Në faqe gjashtë në kategorinë e shpenzimeve komunale shihet se janë rritur në shumë prej 6145.24 € dhe keni potencuar që kjo rritje është si pasojë e obligimeve të trashëguara dhe po që se e marrim raportin e obligimeve të pa paguara për periudhën janar-dhjetorë 2021 keni reportuar se në kategorinë e shpenzimeve komunale obligimet janë zero që do të thotë që nuk është e vërtetë që ka obligime të trashëguara.

**Lindita Ballazhi** thekson:- sa i përket subvacioneve dhe investimeve kapitale shpenzime nuk kemi pasur gjatë tre mujorit të parë dhe kjo është si pasojë që kemi pasur një bllokim më të vonshëm të buxhetit. Sa i përket Ligjit të Buxhetit është një gabim teknik dhe do të përmirësohet. Përqindja është e rrumbullaksuar 14.95 % që gjegjësisht është 15 % dhe besoj që nuk është gabim. Disa fatura janë dërguar në vitin 2022 dhe llogariten si borxhe të trashëguara . Raporti kur është bërë ka qenë deri në muajin dhjetorë dhe deri në ato momente nuk kemi pasur fatura dhe pastaj në muajin janar dhe më andej na janë dërguar faturat.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- faleminderit i nderuar z. Zaim Bela që keni kujdes për çështje të shpenzimeve dhe po më bëhet qefi por të ishit kanë edhe gjatë qeverisjes së më hershme do të ishte më mirë . Sa i përket obligimeve të pa paguara besoni që neve na vijën edhe fatura të pa paguara që nga vitin 2020 dhe nga një herë vijë në zyrën time edhe pa fatura hiq ku kanë mbetur borxhe më herët dhe kur është bërë raporti i shpenzimeve ne nuk kemi pasur asnë informacion dhe kur kemi potencuar se kompjuterët i kemi marr zero zero u duke që sikur ne po bëjmë propaganda politike. Çdo faturë që vjen e që është obligim i pa paguar do ta paguajmë dhe do ta deklarojmë si obligim i pa paguar . Sa i përket përqindjes 14.51 është 15 dhe nuk është gabim.

**Lindita Ballazhi** thekson:- kemi borxhe të trashëguara për vitin 2016, 2019.2020 prej ish qeverisjes dhe jemi shumë të interesuar që t'i kryejmë këta obligime në vitin 2022 me buxhetin e vitit 2022 dhe ato shpenzime që do të kryhen do të paraqiten në raporti gjashtë mujorë apo në raportin një vjeçar të shpenzimeve

**Zaim Bela** thekson:- në faqe dymbëdhjetë dhe trembëdhjetë shpenzimet kapitale janë për periudhën janar-mars dhe siç shihet totali i investimeve kapitale është në shumë 470 000 € dhe ndërsa në faqe katër është shënuar 455 000 € që do të thotë se shuma prej 15 000 € është hequr .

**Hyriete Isufi** thekson:- sa përket mëditjeve dhe shtesave ju përgëzojë që buxheti ka mbetur brenda komunës dhe besoj që me këto mjete do të kryhen edhe pagesat e shujtave.

**Lindita Ballazhi** thekson:- janë hequr dy apo tri projekte sepse në vazhdimësi projektet e njëjtë për çdo vit janë përsëritur dhe shumë vite me radhë nuk janë realizuar e mjetet financiare kanë kaluar në kategorinë rezerva. Sa i përket çështjes së shujtave nga muaji dhjetorë i vitit 2021 po mundohemi me hequr këtë obligim dhe si komunë i kemi përcjell në Ministri por deri më tanë nuk kemi pasur ndonjë sqarim se pse nuk janë ekzekutuar shujtat.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

## U MIRATUA RAPORTI FINACIAR PËR PERIUDHËN JANAR – MARS 2022

### 4. Kërkesë për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2021 në vitin 2022.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- bartja e mjeteve financiare është bërë më vonë në këtë vitë për shkak se pasqyrat financiare janë miratuar me vonesë nga ana e Ministrisë së Finacave . të hyrat e bartura nga viti 2021 në vitin 2021 kanë qenë në shumë prej 57,779.88 € prej tyre janë shpenzuar në shumën prej 57,001.74 €, kanë mbetur edhe 778.14 €. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2021 kanë qenë në shumë prej 325,140.90 €, prej tyre janë të shpenzuara 253,181.28 €, mbetja nga te hyrat e vitit 2021 është 71,959.62€ kurse për bartje në vitin 2022 janë gjithsej 72,737.76 €. Në material i keni të shënuara se në cilat kategori do të barten mjetet financiare.

**Zaim Bela** thekson:- shuma në vlerë prej 70000 € që është paraprë në kategorinë subvencione dhe transfero a është paraparë diku me u dhënë si subvencione . Shuma në vlerë prej 3500 € shërbime në shëndetësinë primare kërkoj sqarim se ku do të shpenzohen.

**Lindita Ballazhi** thekson:- donacionet që bëhen për shoqatat e ndryshme bëhen prej te zyra e kryetarit të komunës nga kategoria subvencione dhe transfere , pagesat e lehonive.

**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:- shuma në vlerë prej 3500 € është planifikuar të ndahen për shkak se te punimet e nxemjes kur janë bërë nuk janë paraparë edhe disa punë që kanë të bëjnë me tavane në QKMF.

**Refet Kalisi** thekson:- gjelbërimi i disa hapësirave publike në shumë prej 18 000 € është një shumë bukur e madhe dhe ku do të shpenzohen, mirëpo unë propozoj që të dedikohen te projekti i parkut të qytetit.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- unë mendojë jo 18 000 € por edhe 180 000 € mi ndarë për gjelbërim do të ishin pak për gjelbërim. Shuma prej 18 000 përfshin parqet e planifikuar në komunën e Hanit të Elezit si te kompleksi “Bllaca” , te “Varrezat e Dëshmorëve” , te komuna. edhe nga garanti i performacës i kemi 82 000 € të cilat do të dedikohen për parkun e qytetit.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

## U MIRATUA KËRKESA PËR BARTJEN E MJETEVE TË PA SHPENZUARA NGA TË HYRAT VETANAKE TË VITI 2021 NË VITIN 2022

### 5. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare për javën kulturore 2022 në Komunën e Hanit të Elezit.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Hisni Luri** thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

**Nora Xhoni** thekson:- për nxënësit e dalluar të jepet një dhuratë simbolike për motivim.

**Zaim Bela** thekson:- në propozim vendim shuma diku shënon 4968 € dhe diku tjetër shënon 4008 € . Çmimet të cilat i keni vendosur më janë dukur shumë të ulëta sepse për çdo dit po ka ngritje të çmimeve.

**Sherif Berisha** thekson:- a jeni konsultuar me të gjitha kategoritë sepse edhe unë po më duken shuma të vogla sidomos te klubi i mundjes sepse tërë ditë zgjatë dhe ata fëmijë duhet të ushqehen.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- cili klub do ta organizon turnirin ndërkombëtarë të mundjes .

**Hisni Luri** thekson:- te çmimet nuk jemi ndalur në detale shumë por është marr siç ka qenë më herët dhe pjesa e agjendës është më ndryshe se tjera herë. Sa i përket shumë është një gabim teknik dhe shumë është 4968 € . Klubi i mundjes “Dardania” do të bartë kompetencat e organizimit shpërbllimet do të janë simbolike brenda mëndësive buxhetore.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- me krahasuar javën kulturore me vitet e kaluara ushqimet i kanë rritur më shumë shpenzimet, pra ne kemi planifikuar me i zvogëluar darkat që kanë kushtuar diku afér 3500 €. Ne kemi menduar me i zvogëluar shpenzimet duke i organizuar ushqimet tradicionale. Turneu ndërkombëtarë më shumë do të jetë organizimi prej federatës së mundjes që do të shkon edhe përmes klubit të mundjes “Dardania”.

**Sherif Berisha** thekson:- sa i përket shpenzimeve që u potencuan për vitet e kaluara është mirë që nëse keni dokumentacione ti publikoni se kush i ka bërë ato shpenzime.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- nuk është qëllimi sekush ka hëngër dhe kush ka pirë por qëllimi dhe ideja është se si me i zvogëluar këtë shpenzim dhe me i bërë punët e njëjtë.

**Hyriete Isufi** thekson:- është shënuar darkë e përbashkët për garuesit e turneut por ata tërë ditën janë në aktivitet dhe është pak problem me pritur që deri në darkë për me u ushqyer . Me vjen mirë që keni menduar ndryshe sepse edhe ne jemi për mos me shpenzuar shumë por jemi për mos me mbetur në baltë për shkak se më lehtë e kemi për me i kthyer mjetet por duhet të analizohet mirë që mos me mbetur keç te çështja e organizimit.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

#### **U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E MJETEVE FINACIRE PËR JAVËN KULTURORE 2022 NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT**

##### **6. Plotësim ndryshimi i rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Hisni Luri** thekson:- në plotësim ndryshim të kësaj rregullore do të ndryshohet vetëm neni 15.1.8.1 Të jetë student në Universitetin Publik të Maqedonisë Veriore ( specifikisht Universitetit Publik i Tetovës, Universitetit Publik “Nëna Terez”). Në konsultat që i kam pasur me persona të ndryshëm kemi menduar që me i përfshirë edhe studentët të cilët studiojnë në Universitetin e Shqipërisë.

**Nora Xhoni** thekson:- edhe në KPF e kemi diskutuar që të jetë një gjithë përfshirje sepse mund të kemi ankesa në të ardhmen sepse ka edhe studentë që studjonë në Shqipëri

**Sherif Berisha** thekson:- propozimi që është bërë për me i përfshirë edhe studentë të të cilët studiojnë në Maqedoninë e Veriut që është shumë e qëlluar dhe ndoshta mund të jetë diskriminim Shqipëria por të fillojmë me studentët që studiojnë në Maqedoninë e Veriut dhe pastaj të shohim dhe mund ta ndryshojmë rregulloren.

**Resul Suma** thekson:- sa i përket Universitetit të Tiranës nuk besoj që ka shumë studentë dhe që kishte mundur me qenë problem për komunën nëse janë dy ose tre pse me i ndarë për shkak se edhe ata janë pjesë e qytetit tonë.

**Zaim Bela** thekson:- unë mendoj që të jetë fakultete publike jashtë shtetit për shkak se kam dëgjuar që ka studentë të cilët studiojnë edhe në Itali. Në qeverisen e më hershme jemi mundur që mos me dal jashtë Kosovës për shkak të mjeteve financiare.

**Refet Kalisi** thekson:- është mirë te jetë për studentët të cilët studiojnë jashtë Kosovës për shkak se mund të kemi ndonjë studentë i cili studiojnë në Zagreb por na bjen një barrë edhe për sigurimin e mjeteve financiare. Edhe në qeverisjen e më hershme kemi dashur me ju ndihmuar por problem ka qenë çështja e mjeteve financiare dhe nëse bëhet plotësim ndryshimi i rregullore e nëse sigurohen edhe mjetet financiare dëtjtë jetë mirë për të gjithë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- ne e kemi diskutuar me drejtorin e arsimit dhe me persona të tjerë që janë njohës në fushën e arsimit dhe në përgjithësi ka qenë ideja si me i stimuluar ata studentët të cilët janë detyrimisht në Universitetin e Tetovës dhe nuk po munden me u regjistruar në Universitet Publike në Kosovë por po detyrohen me u regjistruar që mos me humbur vitin. Ne e kemi diskutuar edhe mënyrën e stimulimit që kur të bëhet ndarja e bursave me pasur kriteret , e jo me kriteret e njëjta të cilat i kanë studentët në Universitetin Publik të Kosovës pra do të subvencionohen drejtimet deficitare.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

#### U VOTUA PLOTËSIM NDRYSHIMI I RREGULLORES PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SË SUBVENCIONEVE QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK

##### 7. Informatë për ndarjen e bursave.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Hisni Luri** thekson:- prej komunës janë ndarë tridhjetë bursa , ndërsa dy mbëdhjetë bursa janë ndarë prej asociacionit të bizneseve që do të thotë janë përfshirë të gjithë studentët të cilët kanë aplikuar

**Sherif Berisha** thekson:- a ka pasur raste që ka aplikuar ndonjë studentë i cili studion në fakultet privatë dhe është përfitues i bursës

**Hisni Luri** thekson:- e di që ka pasur prej studentëve të cilët nuk e kanë merituar që e kanë pasur një vit të humbur por prej asociacionit të bizneseve janë përfshirë, ndërsa në bursat të cilët janë shpërndarë prej komunës nuk ka pasur.

**Sherif Berisha** thekson:- nëse ju është dhënë prej aleancës së bizneseve mendojë që është bërë një diskriminim për arsy se kanë mundur me aplikuar edhe të tjerë nga Universitet Private sepse kanë nevojë për bursë dhe me ju pas mundësuar një formë të aplikimit.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- të gjithë studentët të cilët kanë aplikuar për me marr bursë që ndahet prej komunës i kanë marr gjithë, e atë të cilët kanë qenë jashtë plotësimit të kritereve përmes aplikimit i kemi stimuluar përmes aleancës së bizneseve. Nuk ka pasur konkurs për studentët të cilët studiojnë në universitet private për shkak se ndarja e bursave për dy mbëdhjetë studentë është vullneti i aleancës së bizneseve edhe përkushtimi jonë për me i përfshirë gjithë ata.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas rendit të punës.

## 8. Raporti finansiar për periudhën Janar – Mars 2022 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

**Kryesuesi thekson:-** për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sevime Bajrami** thekson:- materialin e keni në detale dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Nora Xhoni** thekson:- dita e bajramit i bien e Hanë dhe në Lagje të Re në këtë ditë bëhet bartja e mbeturinave nga kompania “Pastrimi” dhe a do të ketë njoftim zyrtarë për këtë cështje

**Sevime Bajrami** thekson:- do të njoftohet kompania për këtë çështje.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kur janë pushimet nuk është mirë që me ndryshuar orarin qoftë një ditë para, qoftë një ditë pas sepse krijohet një konfuzitet i informacionit. Bartja e mbeturinave do të jenë ditët e njëjtë por do të bisedojë me drejtorin për shënimë publike dhe komisionin e aksionarëve që ditët të jenë të njëjtë dhe nëse është e nevojshme punëtorët të kompensohen dhe orari mos me u ndryshuar për shkak se krijohet një farë konfuziteti.

**Zaim Bela** thekson:- nuk e pashë planin për vitin 2022 dhe ju e keni paraqitur vetëm për tre mujorin e parë dhe a keni ndonjë plan që në tre mujorin e parë janë realizuar 20 % në mënyrë që të dihet se sa është realizuar dhe pse nuk është realizuar për shkak se në material këtë çështje nuk ishin të qarta.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kjo është një raport dhe nuk jemi te planet dhe krahasimet janë me vitin 2021 për periudhën e njëjtë..

**Refet Kalisi** thekson:- kërkoj sqarim për paranë në bankë që është paraqitur për vitin 2021 në shumë prej 78 315 € , ndërsa në vitin 2022 në shumë 1127 €. Kërkoj që ta kemi një përshkrim të ekonomive familjare se sa ekonomi familjare paguajnë dhe sa ekonomi familjare nuk paguajnë.

**Sevime Bajrami** thekson:- shuma në vlerë prej 78 315 € ka qenë donacion i komunës që i ka ndarë mjete kompanisë për vitin 2021 dhe me ato mjete është bërë pagesa e kamionit. Sa i përket ekonomive familjare keni qenë në këtë pozitë dhe nuk keni mundur asnjë herë me i siguruar dhe përfaqësuesit e kompanisë kanë deklaruar se asnjë herë nuk mundemi me bërë saktë.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas rendit të punës.

### 9. Тëндрышме.

**Kryesuesi thekson:-** për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

**Sherif Berisha** thekson:- QKMF-ja a është e furnizuar me barna esenciale . Kërkoj përgjigje me shkrim për çështjen e stomatologut se pse nuk po realizohet. Për rreth hekurudhave kemi një problem se është shfaqur dhe kërkoj sqarim për çështjen e dy problemeve që janë te hekurudha për te lagjja Rana dhe te ajo pjesa e stadiumit të futbollit. A është dhënë pëlqim në këtë mandat për te gurëthyesit dhe nëse është dhënë ku është bazuar. Te zhvillimi ekonomik po shohë që kafiterit po punojnë këtyre ditëve , a kanë leje dhe a i kanë kryer obligimet. Te rruga që shkon në drejtim të shkollës fillore te shkallët të cilat janë afér shkollës së mesme “Dardania” është dëmtuar hekuri dhe është mirë të dilet në vend ngjarje dhe të rregullohet. Zebrat në qytet është mirë me i vendosur. Dje e kam parë një fëmijë dymbëdhjetë vjeçar i cili e voziste veturën dhe është mirë me pasur parasysh se mund të shkakton ndonjë problem.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- sa i përket çështjes së hekurudhës kam bërë përpjekje me bërë takime me Ministrin Liburn Aliu. Jam takuar me kryeshefin e Infrakosit dhe Trainkosit dhe sot kam takim me Ministrin e MAPL-së. Kërkesa të ndryshme kam parashtruar në Ministri për këto çështje. Në projektin të cilin po e realizojnë nuk i kanë të paraparë dy vend kalimet sepse siç potencojnë janë të përkokohshme dhe nëse mbyllen e dimë që është keç për qytetarët por ne do të bëjmë përpjekjeve përmes vijës institucionale për me zgjidhur këtë problem. Dje kam pranuar një peticion prej qytetarëve që mos me i mbyllur këto vend kalime dhe unë do të ja paraqesë Institucioneve përgjegjëse. Unë do të ja paraqes edhe Ministrit Liburn Aliu peticionin e qytetarëve edhe pse po ka hezitime për me u taku sepse ne i dimë arsyet politike por nuk duhet të ketë hezitim për me u takuar kur dihet se interes i qytetarëve është më i madhe se një teke i dikujt politik. Si kryetarë komune ka me i bërë përpjekjet e mia për këtë çështje dhe nëse nuk do të realizohen përgjegjësin ne ta marrin ata. Ne kemi bërë një kërkësë në Ministri për çështje të sinjalizimit dhe sot do të vjen dikush prej Ministrisë dhe për çështje të zebrave duhet të marrim leje nga Ministria e Infrastrukturës për me i bërë zebrat në Magjistrale.

**Hyriete Isufi** thekson:- a ekziston mundësi me bërë një mbikalim mbas çerdhes dhe besoj që do të ishte bërë mirë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- sa i përket mbikalim është problemi i çështjes së pronave private se nuk kemi mjete financiare për me bërë shpronësimin sepse çështja e mbikalimit nuk është problem mund të bëhet dirsa mbikalimi mund të bëhet.

**Ajnure Thaçi** thekson:- ka filluar ndarja e shujtave për nxënësit nga klasa e parë deri në të pestën dhe është bërë një punë e mirë por kërkoi informacion për çështje të lëngjeve sepse vetëm ditën e parë i kanë sjell dhe nuk kanë vazhduar.

**Refet Kalisi** thekson:- për çështje të ujit a kanë filluar punimet dhe është mirë me biseduar me drejtorin e kompanisë “Bifurkacioni” për me shpallur konkurs për shkak se duhet edhe katër punëtorë sepse në momentin që lëshohet fabrika duhen edhe punëtorët.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- çështja e pranimit të punëtorëve është çështje e kompanisë së “Bifurkacioni” se sa punëtorë do t’i pranojnë por ne duam shërbime ashtu siç janë zotimet e tyre. Përfaqësuesit e kompanisë “Bifurkacioni” kanë potencuar se brenda Një muaje do të vendosen filtrat dhe projekti i CDI-së deri në muajin qershor do të përfundon dhe besoj që do të kryhet.

**Majlinda Kaloshi** thekson:- si përket obligimeve të cilat kompanitë i kanë ndaj komunës si drejtori i kemi shpërndarë letër kujtesa të cilat i kemi shpërndarë gjatë tre majorit të parë dhe letër kujtesa nuk kanë pasur afat për kryerjen e pagesave por kemi arritur me kaluar shumën nga viti i kaluar, pra është rritur inkasomi i të hyrave te bizneset. Gjatë muajit maj pritet të lëshohen aktvendimet. Sa i përket lëshimit të lejeve nuk kam informacionE të saktë se për cilin biznes bëhet fjalë por nëse keni ndonjë subjekt afaristë të caktuar ma dërgo me imell. Sa i përket pëlqimeve duhet të konsultohem me drejtorin e urbanizmit dhe mund tu jap përgjigje më konkrete.

**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:- për çështjen e rëntgenit janë zhvilluar të gjitha procedurat por ka mbetur me u nënshkruar kontrata.

**Hisni Luri** thekson:- për muajin prill shujtat janë tu ekzekutuar dhe së bashku me shujtat kemi parashtruar kërkësen edhe për lëngjet dhe kemi kërkuar që porosia të vjen një herë për dy javë.

**Arsim Dernjani** thekson:- rregullimi hekrade është bërë afér shkollës së mesme “Dadrdania” rruga që shkon në drejtim të shkollës Fillore “Ilaz Thaçi” .

**Ajnure Thaçi** thekson:- rruga që shkon për fshatin Dimcë në disa vende është prerë asfalti për shkak të punimeve që janë bërë për ujësjellësin dhe duhet të rregullohen.

**Arsim Dernjani** thekson:- pasi të kryhen punimet nga kompania “Bifurkacioni” do të rregullohet rruga sepse duhet të testohen gypat të cilët janë vendosur. Kompania do t’i mbushë me rërë përkohësisht.

**Refet Kalisi** thekson:- te hekurudha që janë duke u zhvilluar punimet është mirë të bëhet kërkesë për me u vendosur dy gypa të kanalizimit për shkak se ujërat e zeza dhe atmosferike janë së bashku me një gyp dhe duhet të ndahen. Gypi të cilën e kanë vendosë nuk e kanë vendosë në tërësi të ri sepse e kanë dëmtuar dhe është mirë me u interesuar se çka është duke u punuar.

**Sevdi Dernjani** thekson:- sa i përket vendosjes së gypave kërkesë kemi parashtruar në “Infrakosë” dhe është miratuar dhe kompania do ta rregullon .

**Xhevahir Dernjani** thekson:- falënderojë donatorët dhe komunën për paketat e ndihmave të cilat janë shpërndarë gjatë muajit të ramazanit dhe si administratorë i fshatit Paldenicë jam shumë i kënaqur me shpërndarjen që është bërë për shkak se nuk kam asnjë ankesë nga banorët sepse herave të tjera kam pas ankesa. Falënderoj kompaninë e cila e ka bërë pastrimin e Xhamive në territorin e komunës së Hanit të Elezit. Drejtoria për shërbime publike është mirë të del në teren ta sheh se a kemi ndonjë defekt te Uji i Glloboçicës. A kemi mundësi prej drejtorisë për bujqësi që me bërë pastrimin e druve të vjetra të cilat i kemi në bjeshkët e tona që me u furnizuar qytetarët duke i marr për bazë se është bërë çmimi i lartë i druve dhe qytetarët me duke paguar taksa të ulëta. Gjatë muajit të ramazanit janë bërë disa vjedhje në Lagjen Meliq, kërkoi që organet e rendit të jenë më të përgatitura apo ne të shtohet stafi në mënyrë që të kemi siguri më të madhe në komunën tonë.

**Kryesuesi** thekson:- nëse stacioni i policisë ka mungesë të stafit duhet të kërkon nga niveli qendrorë që të bëhet shtimi i stafit. shqetësimi më i madh është se në vjedhjet të cilat kanë ndodhë për një kohë janë thyer tri apo katër shtëpi dhe qytetari nuk është njoftuar se është nën hetime apo është duke u intervistuar për me u gjetur ai që e ka bërë veprën dhe kjo është shqetësim për neve si komunitet.

**Arsim Dernjani** thekson:- sa i përket punës në teren gati se çdo ditë dal në teren edhe te burimi i ujit të Glloboçicës dhe te i Dimcës.

**Abduraman Bushi** thekson:- kemi parashtruar kërkesë në inspektoratin e prerjes së drunjve në Prishtinë dhe e kemi marr pëlqimin por janë edhe disa procedura që duhet të i kryen regjioni i Ferizajt.

**Refet Kalisi** thekson:- kërkoi informacion me shkrim nga drejtoria për urbanizëm se sa hektarë pronë ju kanë dhënë dhe a punohet në pronë të kompanisë “Sharrcem” apo pronën e vetë të cilën e ka blerë kompania “Alba”. Drejtoria e Administratës është mirë me bërë kositjen e barit para dhe pas objektit të komunës. Saksia e luleve të cilat janë blerë a i keni donacion apo me buxhet të administratës komunale.

**Malik Berisha** thekson:- a është e njoftuar drejtoresha për shëndetësi për shkrimet të cilat janë bërë në AMF-ën e fshatit Gorancë dhe është mirë që pas orarit të punës që të mbyllët

**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:- në momentin që jam njoftuar për gjendjen e AMF-së e fshatit Gorancë është bërë pastrimi por nuk kam informacione se kush e ka bërë , mirëpo do të kemi kujdes në të ardhmen.

**Malik Berisha** thekson:- nuk është hera e parë për çështjen e AMF-së por duhet të vendosen kamera.


**Natyra Kalisi** thekson:- sa i përket kositjes së barit e kemi parasysh këtë çështje. Saksia e luleve vetëm janë ngjyrosur.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 12:51

Procesmbajtësi

Avni Bushi



**Kryesuesi Kuvendit**  
**Florim Shkreta**